



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 234 Prot.

Tiranë, më dt. 18-04 .2018

VENDIM

Nr.211, dt. 18.04.2018

Në mbështetje të Ligjit nr.9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, dhe VKM nr.280, dt.01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” i ndryshuar me VKM nr.756, dt.26.10.2016, si dhe Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 18.04.2018, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e vazhdimit të procedurave të legalizimeve për objektin “Banesë 2 kate + papafingo + podrum, në rrugën “Bardhyl Pojani” Korçë, me subjekt aplikues z. Ruben Balli, në zonën e mbrojtur të Qendrës Historike Korçë.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI KKR

Arta Dollani

KRYETAR
Mirela Kupçaro Futxhi

